



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Nr. Prot. 525/005 Dt 28.03.2019

Në mbështetje të nenit 17 dhe nenit 24 pika 1 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet Raporti vjetor i punës i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për vitin 2018.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të parapara me Statutin e përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Këshilli Drejtues dhe menaxhmenti, kanë përgatitur raportin e punës për vitin 2018.

Përmes raportit vjetor pasqyrohet veprimtaria e UMIB-it konform obligimeve dhe detyrave ligjore duke u mbështetur në punën efektive gjatë vitit 2018 e cila është drejtuar nga vizioni dhe misioni i saj i udhëhequr nga parimet: profesionale, transparente, etike, të përgjegjshme dhe efektive.

Këshilli Drejtues miratoi Raportin vjetor të punës për vitin 2018 dhe vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- MASHT – it;
- Rektorit të UMIB – it;
- Sekretarit të përgjithshëm të UMIB – it;
- Arkivit.



Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues



**UNIVERSITETI I MITROVICËS
“ISA BOLETINI”**

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2018

Mitrovicë, mars 2019

PËRMBAJTJA

Hyrja	3
I. Aplikimi për riakreditim institucional dhe programet e studimit	4
II. Studentët	5
2.1. Studentët e pranuar respektivisht të regjistruar sipas fakulteteve, programeve dhe viteve të studimit në bachelor dhe master	5
2.1.1. Numri i studentëve të regjistruar – studimet bachelor	5
2.1.2. Numri i studentëve të regjistruar – studimet master	6
2.2. Studentët e diplomuar sipas fakulteteve të UMIB – it në vitin 2018	6
2.2.1. Studentët e diplomuar në nivelin bachelor	6
2.2.2. Studentët e diplomuar në nivelin master	6
III. Puna e organeve qeverisëse të Universitetit	7
3.1. Senati u Universitetit	7
3.2. Këshilli Drejtues	7
IV. Administrata Qendrore	9
4.1. Zyra për çështje akademike	9
4.2. Zyra ligjore	9
4.3. Zyra e personelit	10
4.3.1. Personeli akademik	10
4.3.2. Personeli administrativ – nëpunës civil	11
4.4. Zyra për teknologji informative	11
4.5. Zyra për shërbime të studentëve	12
4.6. Zyra për buxhet dhe financa	13
4.7. Zyra për informim dhe komunikim me publikun	14
4.8. Zyra e prokurimit	16
4.9. Zyra e auditimit	16
V. Sigurimi i cilësisë	17
VI. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar	19
6.1. Bashkëpunimi me institucione të Republikës së Kosovës, kompani publike dhe private dhe shoqata – organizata tjera	19
6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe me IAL publike e private të Kosovës	19
VII. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të njësive akademike	20
7.1. Fakulteti i Gjeoshkencave	20
7.2. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	21
7.3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	22
7.4. Fakulteti Juridik	22
7.5. Fakulteti Ekonomik	23
7.6. Fakulteti i Edukimit	24

HYRJE

Universiteti i Mitrovicës (UMIB) është themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës më 06.03.2013 dhe në kuadër të Universitetit janë përfshirë edhe dy njësitë akademike të UP-së me seli në Mitrovicë – Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë (*ish Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë*) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (*ish Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara dhe ish Shkolla e Lartë Teknike*). Universiteti është themeluar që të ofrojë arsimim akademik, kërkime shkencore dhe krijimtari artistike. UMIB bazuar në Statutin e Përkohshëm është institucion autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Andaj funksionalizimi i UMIB-it është bërë duke u mbështetur në fakultetet e trashëguara dhe të riorganizuara, dhe në përgjithësi për gjashtë fakultetet që tani janë të organizuara në kuadër të UMIB-it: Fakulteti i Gjeoshkencave; Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; Fakulteti Juridik; Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit.

Përmes raportit vjetor pasqyrohet veprimtaria e UMIB-it konform obligimeve dhe detyrave ligjore duke u mbështetur në punën efektive gjatë vitit 2018 e cila është drejtuar nga vizioni dhe misioni i saj i udhëhequr nga parimet: profesionale, transparente, etike, të përgjegjshme dhe efektive.

UMIB dhe njësitë akademike në kuadër të saj janë duke punuar me përkushtim që të sigurojnë ngritje kualitative, arsimore – profesionale dhe shkencore në fushat të cilat studiohen në UMIB, andaj mësimdhënia dhe mësim nxënia janë proces i pandarë prej punës kërkimore shkencore në mënyrë që të sigurohet ngritja e cilësisë.

Të arritura e periudhës raportuese janë si rezultat i punës së stafit të Universitetit në përgjithësi dhe të fakulteteve, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në kryerjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të detyrave të punës.

Si të arritura me rezultate konkrete për periudhën raportuese janë:

- Përmbyllja me sukses e obligimit lidhur me aplikimin e personelit akademik në platformën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim e akreditimi.
- Rekrutimi me sukses i personelit akademik të rregullt në përmbyllje të kriterit për riakreditim, si dhe rekrutimi i personelit akademik të angazhuar me honorar.
- Përmbyllja me sukses e konkurseve për regjistrimin e studentëve në nivelin bachelor dhe master në kuadër të 16 programeve të studimit.
- Krijimi dhe avancimi i bashkëpunimeve vendore dhe ndërkombëtare.
- Funksionalizimi i mëtejshëm i një administrate për ngritjen e cilësisë të shërbimeve administrative për studentët dhe personelin. Në bashkëpunim me MASHT dhe MF, Universiteti ka arritur pavarësinë financiare në menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit të Universitetit duke certifikuar zyrtarët përkatës financiar. Pavarësimi në ekzekutimin e buxhetit të lejuar dukshëm e ka rritur dhe do ta rritë performancën e menaxhimit dhe ekzekutimit të buxhetit.

- Vazhdimi i projektit në ndërtimin e objekteve për nevoja të Universitetit dhe të fakulteteve në kuadër të KAMPUS it UNIVERSITAR në Mitrovicë. Në këtë drejtim, ju njoftojmë se të gjitha fakultetet e Universitetit të Mitrovicës janë transferuar dhe janë vendosur në objektin e KAMPUS it të ri universitar me sipërfaqe 17.000 metra katror, gjithashtu edhe rektorati dhe Administrata Qendrore është vendosur në objektin e rektoratit në kuadër të KAMPUS it të ri universitar me sipërfaqe prej 2.000 metra katror. Në përfundim e sipër janë punët në objektin nr. 2 të fakulteteve me sipërfaqe prej 12.000 metra katror. Në fund vit të 2018 së ka filluar së realizuari furnizimi i objektit të fakulteteve me inventar, projekt i financuar dhe i realizuar nga Ministria e Administratës Publike.

Rezultatet e arritura në implementimin e aktiviteteve të lartcekura janë një bazë e mirë për zhvillimin e vazhdueshëm të Universitetit për realizimin e misionit.

Andaj, UMIB, në vitet pasuese do të ketë suksese edhe më të mëdha duke qenë të përkushtuar dhe të udhëhequr nga puna, ndërtimi i raporteve të besimit dhe respektit të ndërsjellët.

I. APLIKIMI PËR RIAKREDITIM INSTITUCIONAL DHE PROGRAMET E STUDIMIT

Në pamundësi për të zhvilluar procesin e vlerësimit të një numri të programeve të studimit, të cilat kanë qenë të akredituara deri më 30.09.2018, KSHC ka nxjerr vendim me të cilin iu është vazhduar akreditimi këtyre programeve për një vit akademik respektivisht deri më 30.09.2019. Gjithashtu për programet e akredituara deri më 30.09.2020, KSHC ka nxjerr vendim për zgjatjen e akreditimit deri më 30.09.2021.

Në kuadër të procesit të riakreditimit/akreditimit, gjatë vitit 2018, respektivisht gjatë muajit tetor, Universiteti i Mitrovicës ka aplikuar për akreditim institucional dhe gjithashtu ka aplikuar për riakreditim/akreditim të 11 programeve të studimit dhe atë:

1. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore:
 - Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore (bachelor dhe master)
 - Teknologji (bachelor dhe master)
2. Fakulteti i Gjeoshkencave:
 - Vendburimet e lëndëve të para minerale (master)
 - Xehetari (bachelor dhe master)
 - Gjeoinformatikë (bachelor)
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Komjuterike:
 - Inxhinieri Ekonomike (master)
4. Fakulteti Ekonomik:
 - Biznes dhe Menaxhment (bachelor dhe master)

II. STUDENTËT

2.1. Studentët e pranuar respektivisht të regjistruar sipas fakulteteve, programeve dhe viteve të studimit në bachelor dhe master

Në Universitetin e Mitrovicës në kuadër të 6 fakulteteve në vitin akademik 2018/2019 janë duke vijuar studimet gjithsejtë 2823 studentë në të gjitha vitet e studimit, në studimet bachelor dhe master. Në vazhdim në tabelat si më poshtë shihet numri i studentëve të regjistruar sipas fakulteteve, programeve dhe vitit të studimit si dhe struktura gjinore e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, në bachelor dhe master:

2.1.1. Numri i studentëve të regjistruar – studimet bachelor

Fakulteti-programi i studimeve	Viti i I	Viti i II	Viti i III	Viti i IV	Struktura gjinore e përgjithshme		
					F	M	Gjithsejtë
Fakulteti i Gjeoshkencave	61	35	86		36	146	182
- Xehetari	29	9	54		1	91	92
- Gjeologji	22	16	26		27	37	64
- Materiale dhe Metalurgji	10	10	6		8	18	26
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	189	99	131		275	144	389
Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	145	63	100		196	112	308
Teknologji	44	36	31		79	32	111
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	427	149	243		355	464	819
- Makineri Prodhuese	55	17	25		9	88	97
- Informatikë Inxhinierike	188	70	101		131	228	359
- Inxhinieri Ekonomike	184	62	117		215	148	363
Fakulteti Juridik	188	90	78	48	242	162	404
- Juridik	188	90	78	48	242	162	404
Fakulteti Ekonomik		41	147		84	104	188
- Banka, Financa dhe Kontabilitet		19	85		53	51	104
- Menaxhment dhe Informatikë		22	62		31	53	84
Fakulteti i Edukimi	203	155	151	114	586	37	623
- Edukim Fillor	134	111	121	86	417	35	452
- Edukim Parashkollor	69	44	30	28	169	2	171
Gjithsejtë	1068	569	836	162	1578	1057	2635

2.1.2. Numri i studentëve të regjistruar – studimet master

Fakulteti – programi i studimeve	Viti i I	Viti i II	Struktura gjinore e përgjithshme		
			F	M	Gjithsejtë
Fakulteti i Gjeoshkencave	20	27	7	40	47
- Xehetari	5	9	1	13	14
- Hidrogeologji dhe Gjeologji inxhinierike	9	7	3	13	16
- Vendburime të lëndëve të para minerale					
- Materiale					
- Metalurgji	6	11	3	14	17
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	38	59	67	30	97
Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	29	42	53	18	71
Teknologji - Inxhinieri i mbrojtjes së mjedisit	9	17	14	12	26
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike		44	20	24	44
- Teknologji Prodhuese - Profili i Prerjes		13	5	8	13
- Informatikë Inxhinierike		29	15	14	29
Teknologji Prodhuese Profili i deformimit		2		2	2
Gjithsejtë	58	130	97	94	188

2.2. Studentët e diplomuar sipas fakulteteve të UMIB-it në vitin 2018

2.2.1. Studentët e diplomuar në nivelin bachelor

Fakulteti	Meshjkuj	Femra	Gjithsejtë
Fakulteti i Gjeoshkencave	19	4	23
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	9	25	34
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	39	20	59
Fakulteti Juridik	17	10	27
Fakulteti Ekonomik	23	33	56
Fakulteti i Edukimit	4	67	71
Gjithsejtë	111	159	270

2.2.2. Studentët e diplomuar në nivelin master

Fakulteti	Meshjkuj	Femra	Gjithsejtë
Fakulteti i Gjeoshkencave	13	5	18
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	4	17	21
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	5	4	9
Fakulteti Juridik			
Fakulteti Ekonomik			
Fakulteti i Edukimit			
Gjithsejtë	22	26	48

III. PUNA E ORGANEVE QEVERISËSE TË UNIVERSITETIT

3.1. Senati i Universitetit

Gjatë vitit 2018, Senati ka mbajtur gjithsej 6 (gjashtë) mbledhje pune ku janë shqyrtuar çështje nga përgjegjësitë e Senatit në harmoni me Statutin e Përkohshëm të UMIB-it. Në kontinuitet me punën e Senatit janë mbajtur edhe mbledhjet e Komisionit të studimeve, i formuar në harmoni me Statutin e UMIB –it dhe e ka rolin e organit këshillëdhënës për Senatin, dhe Komisioni për ankesa, që i kanë paraprirë mbledhjeve të Senatit. Ndër çështjet kryesore të shqyrtimit, në vitin 2018, kanë qenë: Procesi i aplikimit për akreditim/riakreditim të programeve të studimit; konkursi për pranimin e studentëve të rinj në nivelin bachelor dhe master; konkursi për rekrutimin e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune dhe konkursi për angazhimin e personelit akademik me honorar; mbarëvajtja e procesit mësimor; nxjerrja e akteve normative bazuar në rekomandimet e ekspertëve të jashtëm etj, këtu duhet përmendur disa nga rregulloret: Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB; Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në UMIB; Rregullore për mobilitet akademik të studentëve në UMIB; Rregullore për studimet bachelor në UMIB dhe Rregullore për studimet master në UMIB. Gjatë vitit 2018 Senati ka zbatuar vendimin e Këshillit Drejtues lidhur me procesin e zgjedhjes të anëtarëve të Këshillit Drejtues për mandatin 2018-2021.

3.2. Këshilli Drejtues

Gjatë vitit 2018, Këshilli Drejtues (KD) ka mbajtur gjithsej 7 (shtatë) mbledhje pune ku janë shqyrtuar çështje nga përgjegjësitë e KD në harmoni me Statutin e Përkohshëm të UMIB-it. Shqyrtimet lidhur me miratimin e raporteve financiare periodike, raporti dhe vjetor si dhe planifikimi i buxhetit për Universitetin e Mitrovicës për vitin 2019 kanë qenë ndër çështjet kryesore të shqyrtimit në vitin 2018.

Gjatë shqyrtimit të raporteve financiare, Këshilli Drejtues ka bërë një analizë përmbledhëse të performancës së burimeve dhe realizimin e të gjitha shpenzimeve të specifikuar nëpër kategoritë ekonomike për vitin fiskal 2018. Përmes pasqyrave financiare në mënyrë analitike janë pasqyruar burimet e financimit duke specifikuar dhe analizuar alokimet, realizimin, ndërlidhjen me politikat programore dhe vendimeve si nga niveli qendror-Ministria e Financave, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe vendimeve nga vetë Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës.

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës, pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve Publike dhe Planit Strategjik të Arsimit të Lartë të Kosovës për vitet 2017-2021.

Kufijtë final të strukturuar nëpër kategori ekonomike në masë të madhe në aspektin financiar nuk janë ndërlidhur me përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara sipas Kornizës Afatmesme e

Raporti vjetor 2018

Shpenzimeve për vitet 2018-2020 për UMIB dhe Planin Strategjik për vitet 2018/2021 për Universitetin e Mitrovicës.

Mungesa e mjeteve buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike bëri që menaxhmenti të përcaktoj prioritete të reja duke hartuar programin për racionalizim të shpenzimeve. Masa buxhetore ndikoi në realizim të aktiviteteve dhe nivelin e shërbimeve për studentë.

Sfiduese për këtë vit fiskal ishte: organizimi për implementim të vendimit për hapje të kampusit të ri universitar dhe procesi i rekrutimit të personelit të ri akademik të rregullt dhe të angazhuar.

Pasqyrimi i specifikave dhe vështirësitë të cilat ishin të trashëguara nga viti fiskal 2017, vendimet dhe kërkesat shtesë të drejtuara institucioneve relevante të vendosjes lidhur me minusin në paga janë treguar si produktive, me faktin se Qeveria e Kosovës aprovoi kërkesën për akordim të mjeteve shtesë duke mundësuar që të finalizohet procesi i rekrutimit dhe përmbushja e obligimeve financiare për këtë kategori ekonomike.

Hartimi dhe implementimi i programit për racionalizim të shpenzimeve në kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale, mundësoi që të bëhet ristrukturim ndërmjet zërave shpenzues. Mjetet janë destinuar në zëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në avancim të punës dhe krijim të kushteve më të mira për studentët e Universitetit të Mitrovicës.

Për periudhën pesëvjeçare të funksionimit të Universitetit të Mitrovicës vërehet se në kontinuitet është ngritur niveli i menaxhimit të financave që ndërlidhet me planifikim, mbikëqyrje dhe realizim të mirë të buxhetit.

Menaxhimi financiar dhe sukseset e arritura janë të lidhura ngushtë me kërkesën për pavarësim financiar, duke konsideruar se UMIB-i finalizoi strukturimin dhe ngritjen profesionale të përgjegjësve në fushën e menaxhimit të financave publike.

Nga pasqyrat financiare vërehet se në kontinuitet është ngritur masa buxhetore dhe paralel me këtë edhe indeksi i realizimit të buxheti që ishte si rrjedhojë e qasjes së re të menaxhimit dhe aplikimit të punës ekípore.

Në funksion të menaxhimit të mirë të buxhetit, por njëkohësisht edhe në funksion të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, KD ka vazhduar të respektoj vendimin për deklarim të pagës primare të personelit të UMIB-it (vendimi nr. 443/005 i datës 31.3.2017).

Procese të tjera me rëndësi të zhvilluar nga Këshilli Drejtues, gjatë këtij viti janë edhe:

- Miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Mitrovicës për periudhën 2018 – 2021;
- Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues nga stafi akademik, të zgjedhur nga Senati i Universitetit të Mitrovicës dhe konstituimi i Këshillit të ri Drejtues për mandatin 2018 – 2021;
- Raporti i Zyrës për zhvillim akademik lidhur me pyetësorët, një proces ky i rëndësishëm për procesin e akreditimit;

- Raporti i auditimit, i cilësuar si mjaft i suksesshëm për punën vjetore të UMIB-it si institucion.

IV. ADMINISTRATA QENDRORE

4.1.ZYRA PËR ÇËSHTJE AKADEMIKE

Në kuadër të përgjegjësi të paraprara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës Zyra për çështje akademike, në bashkëpunim me zyrën e personelit ka zhvilluar proceset e rekrutimit të personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune dhe personelin akademik të angazhuar me honorar. Të dy proceset janë zhvilluar në bazë të vendimeve dhe konkurseve të shpallura nga Senati i Universitetit.

Në proces të realizimit të konkurseve dhe vendimeve të Senatit për angazhimin e personelit akademik për vitin 2018/2019, zyra për çështje akademike ka hartuar gjithsejt 114 kontrata për personel të angazhuar me mbinormë dhe honorar për vitin akademik 2018/2019, kurse në zbatim të vendimeve për zgjedhje në thirrje apo avancimeve ka hartuar gjithsejtë 16 kontrata. Gjatë viti 2018, zyra gjithashtu ka hartuar vendime për pensionim të punëtorëve – personel akademik, informata, analiza dhe raporte të ndryshme statistikore për personelin akademik, për institucionet qendrore (MASHT; MAP dhe MF), gjithashtu edhe raporte të brendshme për menaxhmentin e UMIB – it, duke bërë edhe azhurnimin e të dhënave për personelin akademik.

4.2.ZYRA LIGJORE

Gjatë vitit 2018, në harmoni me Statutin e Përkohshëm, është vazhduar puna për krijimin e kornizës ligjore për funksionalizimin e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”.

Kështu, përveç këtyre Rregulloreve:

1. Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;
2. Rregullore mbi punën e Këshillit Drejtues;
3. Rregullore mbi punën e Senatit;
4. Kodi i Etikës;
5. Rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme në UMIB;
6. Rregullore mbi zgjedhjet në UMIB dhe punën e Këshillit të Fakultetit;
7. Rregullore për zgjedhjet e studentëve të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;
8. Rregullore mbi punën e parlamentit dhe këshillave të studentëve;
9. Rregullore mbi përgjegjësinë disiplinore të studentëve;
10. Rregullorja për standardet e mbrojtjes dhe ruajtjes së lëndës arkivore;
11. Rregullorja për menaxhim zyrtar dhe arkivor;
12. Lista e kategorive të materialit dokumentar me afate të ruajtjes të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;
13. Rregullorja për menaxhim zyrtar dhe arkivor në fakultetet e UMIB-it;

14. Lista e kategorive të materialit dokumentar me afate të ruajtjes të fakulteteve të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;
15. Rregullore për të ardhurat personale në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”;
16. Rregullore për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”;
17. Rregullore për regjistrim në librin e vizitorëve të personave që hyjnë dhe dalin nga ndërtesa e Rektoratit.

gjatë vitit 2018, janë miratuar edhe rregulloret si në vijim:

18. Rregullore (e ndryshuar) për publikime të UMIB – it;
19. Rregullore për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB;
20. Rregullore e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në UMIB;
21. Rregullore për mobilitet akademik të studentëve në UMIB;
22. Rregullore për themelimin dhe mënyrën e funksionimit të trupave këshillëdhënëse të njësisve akademike;
23. Rregullore (e ndryshuar) për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UMIB;
24. Rregullore për studimet bachelor në UMIB;
25. Rregullore për studimet master në UMIB.

Zyra ligjore ofron shërbimet e sekretarisë për organet që veprojnë në kuadër të UMIB-it si: Këshilli Drejtues; Senati i Universitetit; Komisioni i Studimeve i Senatit dhe Komisionet tjera të formuara në nivelin qendror të universitetit. Kjo zyrë, gjithashtu, përfaqëson universitetin në kontestet gjyqësore dhe administrative, gjatë vitit 2018 dukshëm është rritur numri i lëndëve në gjykata dhe organet e administratës.

4.3.ZYRA E PERSONELIT

Gjatë vitit 2018, Zyra e personelit në bashkëpunim me zyrën për çështje akademike, ka zhvilluar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga autorizimi i pozitave, shpallja e konkursit, deri në emërimin dhe publikimin e kandidatëve të suksesshëm, kompletimi i dosjeve të kandidatëve dhe regjistrimi i tyre në sistemin e pagave. Në bashkëpunim me zyrën për buxhet dhe financa është bërë kalkulimi i pagave mujore të punësuarve dhe të angazhuarve në Universitetin e Mitrovicës.

4.3.1. Personeli akademik

Gjatë vitit 2018 janë plotësuar gjithsejt 20 (njëzetë) vende të punës – personel akademik në marrëdhënie të rregullt pune sipas fakulteteve si në vijim:

- Fakulteti i Gjeoshkencave: tre mësimdhënës -avancim
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore: tremësimdhënës dhe dy asistentë

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike: dy mësime dhe shtatë asistentë
- Fakulteti Juridik: një mësime
- Fakulteti i Edukimit: një mësime dhe një asistentë

Në kuadër të konkursit plotësues për angazhimin e personelit akademik, në mungesë të personelit të rregullt, Universiteti ka angazhuar gjithsejtë 32 mësime dhe asistentë dhe ka lëshuar po aq kontrata për honorar.

4.3.2. Personeli administrativ

Sa i përket të dhënave për personel administrativ, gjatë vitit 2018 janë plotësuar gjithsejtë, 5 pozita pune, një zyrtar për shërbime studentore në Fakultetin e Teknologjisë ushqimore, një zyrtar për mirëmbajtjen e ueb faqes në administratën qendrore, nëpërmes konkurseve të jashtme kurse nëpërmes konkurseve të brendshme janë zgjedhur dhe emëruar dy sekretar të fakulteteve dhe një zyrtar i lartë për buxhet dhe financa. Gjithashtu në pamundësi për të rekrutuar nëpunës administrativ, për pozitat e lira dhe shumë të nevojshme për fakultetet dhe administratën qendrore, me vendim të Këshillit Drejtues janë zhvilluar procedurat e konkursit për angazhim për 5 pozita të punës – nëpunës civil me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta dhe atë, 3 – zyrtar për shërbime studentore, 1 – zyrtar i prokurimit dhe 1 – zyrtar ekzekutiv.

Zyra e Personelit ka vazhduar të kryej punët në:

- Hartimin e raporteve të ndryshme statistikore për nevojat e MAP-it,
- Futja e të dhënave në SIMBN për nëpunësit civil
- Futja e Planit të Personelit në SIMBNJ etj.

Sfiduese për Zyrën e Personelit mbetet rekrutimi i nëpunësve civil pasi që në mungesë të buxhetit UMIB nuk ka arritur të bëjë rekrutimin e personelit administrativ në harmoni me planin e personelit për vitin 2018. Pamundësia për të rekrutuar personelin administrativ sipas planit të personelit ka bërë që një numër i madh i personelit të jenë të angazhuar për më shumë pozita pune.

Universiteti i Mitrovicës është ende në fazën e funksionalizimit, por gjatë viti 2018 kemi qenë të përfshirë në të gjitha trajnimet që i ka organizuar IKAP. Në kuadër të hartimit të Planit të personelit, UMIB ka hartuar edhe planin e trajnimit për nëpunës civil për vitin 2019.

4.4.ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Në kuadër të përgjegjësi të paraprara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës Zyra për teknologji informative, për të rritë efikasitetin dhe për ti zvogëluar problemet ka realizuar projektin e kalimit nga SEMS – Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve në SMU - Sistemin e Menaxhimit Universitar. Sipas kontratës UMIB 979-18-026-225/979000-18-026-225 të datës 01.10.2018 është lidhë kontrata publike kornizë – shërbim me një operator ekonomik. Shërbimet e mirëmbajtjes së SMU-së do të kryhen nga operatori ekonomik N. Sh. T. UniSoft Prishtinë, kompania në fjalë i ka kryer shërbimet për UMIB mbi dy vite pa pagesë. Kontrata e nënshkruar është 3 vjeçare dhe do të jetë në shfrytëzim me të gjitha modulet duke filluar

Raporti vjetor 2018

nga 01.10.2018 deri më 01.10.2021. Avancimi dhe zhvillimi i programit të SMU – së, migrimi i të dhënave nga sistemi i vjetër në të riun, si dhe të kryej shërbimet për këto module: Moduli i aplikimit online, Moduli i verifikimit online, Moduli i regjistrimit, Moduli i notimit online, Moduli i ID Kartelave, Moduli i diplomave, - Moduli i financave, Moduli i cilësisë. Lidhur me aplikimin e këtyre moduleve nga stafi, zyra ka organizuar trajnime.

Zyra ka vazhduar që të kryej edhe punët në:

- Lëshimin e ID kartelave për studentët e pranuar në UMIB;
- Furnizimin me pajisje Harduerike për nevojat e UMIB-it;
- Mirëmbajtja e Pajisjeve të Teknologjisë Informative.

Nga aktivitetet e realizuara nga zyra vlen të përmenden:

- Zyra ka vazhduar futjen e të dhënave edhe në sistemin SMIAL (Sistemi i Menaxhimint të Informatave në Arsimin e Lartë) të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2018/19, stafin akademikë dhe administrativë;
- Krijimi i kushteve teknike për mirëmbajtje të faqes Web të UMIB-it;
- Hapja e emajlave për punëtorët e ri të pranuar në UMIB në domenin umib.net;
- Sigurimi i shërbimeve të telefonisë dhe internetit me shpejtësi edhe më të madhe se ajo ekzistuese, është realizuar nëpërmes kontratës kornizë nga OE Telekomit i Kosovës;
- Instalimi i rrjetit kompjuterik, si dhe interneti në njësit akademike dhe Rektorat;
- Sigurimi i mbështetjes nga MAP me licensa një vjeçare për sistem operativ WIN10 Education, programe Microdoft SQL Server 2016 Standard Edition, Microsoft Visual Studio 2015 Enterprise etj;
- Menaxhimi për furnizim me pajisje te Server Room-it në Kampusin Universitar, furnizim dhe shtrirje të kablrit optik për lidhje ndërmjet objekteve në Kampusin Universitar dhe Telekomit e Kosovës, furnizim të Switch optik për mundësimin e internetit në Objketin 1 në Kampusin Universitar., menaxhimi, përshtatja dhe montimi i centralit analog në Rektorat në Kampusin Universitar nga objekti i vjetër i Rektoratit, menaxhimi dhe dizajnimi i ndriçimit të Parkut Botanik në Kampusin Universitar.

4.5.ZYRA PËR SHËRBIME TË STUDENTËVE

Zyra për shërbime të studentëve, duke përfshirë këtu edhe shërbimet studentore të fakulteteve, gjatë vitit 2018 është ballafaquar me procesin e konkursit të studentëve në studimet bachelor dhe master dhe me një numër më të madhë të kandidatëve që kanë aplikuar për një vend studentit në UMIB. Në përkrahje të plotë edhe të rektoratit dhe të fakulteteve është zhvilluar një proces i rregullt dhe transparent i pranimit të studentëve të ri për vitin akademik 2017/2018. Në përfundim të procesit UMIB, ka futur të dhënat e studentëve në programin e SEMS-it (sistemi elektronik për menaxhimin e studentëve), gjithashtu UMIB ka futur të dhënat edhe në platformën elektronike të MASHT-it SMIAL (sistemi për menaxhimin e informatave në arsimin e lartë).

Raporti vjetor 2018

Zyra ka vazhduar që të kryej edhe punët në:

- Lëshimin e ID kartelave për studentët e pranuar në UMIB, në bashkëpunim me zyrën e TI – së;
- Lëshimin e diplomave për studentët e diplomuar;
- Lëshimin e vërtetimeve për nevoja të studentëve për botën e jashtme etj.

4.6.ZYRA PËR BUXHET DHE FINANCA

Departamenti për buxhet dhe financa në baza periodike ka hartuar raporte financiare për rektorin. Raportet financiare janë shqyrtuar dhe miratuar nga Këshilli Drejtues.

Buxheti final për vitin 2018 ishte **3.154.746.05** euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është më i lartë për 50.886.16 euro ose me indeks prej 1.64% (3.103.859.89).

Buxheti i aprovuar është realizuar në shumë prej **2.890.272.91** euro ose me indeks prej 91.62% që në krahasim me vitin 2017 është më i ulët për 7.24%. Në indeks të realizimit ndikuan: vendimet e vonuara për ridestinim të mjeteve nga Qeveria dhe MF, procedurat e stërzgjatura të ligjit mbi prokurim dhe harmonizimi i shpenzimeve komunale si rrjedhojë e prolongimit të inaugurimit të kampusit të ri universitar.

Nga pasqyrat në raportin vjetor të hyrave dhe shpenzimeve, vërehet se në kontinuitet është ngritë masa buxhetore dhe paralelë me këtë edhe indeksi i realizimit që ishte si rrjedhojë e qasjes së re të menaxhimit dhe aplikimit të punës ekipore.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokim, zotim, realizim dhe indeks të realizimit:

Kategoritë ekonomike	Buxheti FINAL për 2018	Alokimi	Mjetet shpenzuara	Zotimet/ obligimet pa shlyera	Shpenzimet planifikuara	Mjetet e pashfrytezuara	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
1	2	3	4	5	6=4+5	7=3-6	8=6/2*100	9=4/3*100
Paga & Mëditje	2.376.887.75	2.376.887.75	2.347.618.25		2.347.618.25	38.998.50	98.36	98.77
Mallra&Shërbime	371.339.00	371.339.00	281.639.44	89.640.10	371.279.54	59.46	100.00	75.84
Shpenzime komunale	160.200.00	160.200.00	113.188.10	0.00	113.188.10	47.011.90	71.00	70.65
Subvencione	30.000.00	30.000.00	29.999.75	0.25	30.000.00	0.00	100.00	100
Kapitalet	216.319.30	216.319.30	117.827.37	98.356.63	216.184.00	135.30	100.00	54.47
Total	3.154.746.05	3.154.746.05	2.890.272.91	187.996.98	3.078.269.89	86.205.16	97.57	91.62

4.7.ZYRA PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Në kuadër të përgjegjësive të paraprara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, pas hartimit të planit të punës për vitin 2018, ka vazhduar përmbushjen e tij në detaje ashtu siç ishte planifikuar. Duke marrë parasysh përgjegjësinë që ka sa i përket imazhit të UMIB-it karshi publikut, mund të cilësohet si një vit jashtëzakonisht i suksesshëm. Raportet e krijuara me media janë shumë korrekte dhe kjo ka bërë që edhe menaxhimi i aktiviteteve që lidhen me mediet të shkoj mirë. Komunikatat e dërguara nga Zyra për informim dhe me publikun botohen zakonisht pa ndërhyrje në shumicën e medieve, dhe kjo tregon për besimin e krijuar nga mediet. Nuk ka pasur asnjë rast të keq citimit apo keqinterpretimit. Nuk ka pasur asnjë rast të vetëm që Zyra për informim dhe komunikim me publikun të bëjë reagim ndaj artikujve të botuar. Të gjitha komunikatat e zyrës që janë dërguar për botim, janë botuar në medie në kontekst pozitiv.

Më konkretisht gjatë vitit 2018 janë realizuar këto aktivitete:

- Është botuar broshura për 5-vjetorin e Universitetit “Isa Boletini”;
- Është përgatitur skenari dhe është xhiruar filmi për Universitetin “Isa Boletini”;
- Gjatë gjithë vitit ka pasur 7 kërkesa për qasje në dokumente publike që kanë marrë përgjigje pozitive brenda afatit;
- Janë aranzhuar 4 intervista të rektorit në TV;
- Janë dhënë 5 deklaratë për TV të ndryshme;
- Janë bërë 9 pyetje nga mediet që kanë marrë përgjigje me kohë;
- Janë përgatitur dhe shpërndarë 78 komunikata;
- Janë botuar 43 lajme pozitive për UMIB-in në portale dhe gazeta;
- Janë realizuar 2 TV – kronika problemore për UMIB-in.

Administrimi dhe menaxhimi i ueb faqes zyrtare të UMIB-it

Në kuadër të administrimit dhe menaxhimit të ueb faqes zyrtare të UMIB ka ngritje cilësore, marr parasysh se janë ndërmarr hapa konkret në këtë drejtim:

- **Përkrahja e gjuhës angleze në ueb**, - është aktivizuar dhe konfiguruar moduli që lejon përkrahjen e ueb faqes multi-linguistike. Tashmë ueb faqja është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën angleze.
- **Hulumtimet dhe publikimet shkencore**, - duke u bazuar në ueb faqet e universiteteve tjera me renome, është parë nevoja që edhe ueb faqja e universitetit të Mitrovicës të ketë një seksion të

veçantë ku shfaqen publikimet shkencore të stafit akademik të Universitetit në detaje duke përfshirë revistat shkencore ku janë publikuar si dhe ku rekomandohet të publikohen punimet e radhës.

- **CV-të e stafit akademik**, - janë ngarkuar në ueb CV-të e stafit akademik të Fakultetit Ekonomik, pasi janë të vetmet që kemi pranuar deri më tash. Sidoqoftë kemi bërë kërkesën nga dekanët e fakulteteve përkatëse të na dërgojnë CV-të e stafit të tyre.
- **Programi Erasmus**, - duke parë rëndësinë që ka programi Erasmus+ për studentët tanë dhe stafin akademik, e kemi parë të nevojshme që uebi të ketë një seksion të veçantë në meny dhe kemi krijuar një faqe që përmban informacion të nevojshëm rreth mundësive që ofron ky program, gjithashtu kemi bërë që programi në fjalë të jetë më i dukshëm për vizitorët e uebit.
- **Interaksioni me vizitorë**, - kemi ofruar në ueb mundësinë që vizitorët e mundshëm të kenë mundësinë të na kontaktojnë përmes ueb faqes dhe kështu të kenë mundësinë e ankesës, kërkesës apo sugjerimeve eventuale. Këto porosi nga vizitorët vijnë në postën zyrtare të Universitetit info@umib.net. Tashmë Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini“ ka edhe faqen zyrtare në Facebook si dhe kanalën zyrtar për video në Youtube. Të gjitha lajmet nga ueb faqja tashmë postohen edhe në Facebook. Intervistat e ndryshme dhe video lajmet për universitetin tonë tashmë postohen në kanalën zyrtar në Youtube. Ueb faqja zyrtare tashmë shfaq storie të realizuara me studentët e suksesshëm në UMIB si storie suksesi në mënyrë që të motivohen studentët tanë si dhe vizitorët e jashtëm të jenë në dijeni për mbarëvajtjen e punës së universitetit. Për shkaqe transparence, ueb faqja e universitetit numëron numrin e stafit akademik, studentëve, fakulteteve si dhe personelin e administratës qendrore. Përmes ueb faqes mund të bëhet aplikimi online për qasje në dokumente zyrtare, kjo realizohet duke plotësuar formën që merr të dhënat e kërkuarit dhe që vijnë në postën zyrtare të UMIB-it. Po ashtu nga ueb faqja mund të shkarkohet dokumenti i kërkesës për qasje në dokumente zyrtare.
- **Siguria e uebit**, - janë marrë masa serioze në përforcimin e sigurisë së uebit për preventim nga sulmet kibernetike duke ndryshuar linkun e qasjen në ueb nga administratori dhe pamundësimi i personave të jashtëm të insertojnë skripta të dëmshme përmes komenteve.
- **Përditësimi i përmbajtjes**, - janë publikuar buletinet në fakultete. Janë përgatitur dhe postuar në ueb, të gjitha vendimet e Senatit dhe Këshillit Drejtues, që janë marrë në vitin paraprak. Janë postuar në ueb të gjitha konkurset, shpalljet dhe njoftimet e UMIB-it. Janë postuar më kohë të gjitha njoftimet për afatet e provimeve nëpër linçet e fakulteteve. Në vazhdimësi është bërë përditësimi i përmbajtjes me ndryshimet përkatëse si dhe postimi i njoftimeve dhe lajmeve me rëndësi.

4.8.PROKURIMI

Zyra e prokurimit e UMIB – it ka hartuar Planin e prokurimit për vitin 2018 dhe gjithashtu edhe Raportin vjetor të kontratave të nënshkruara.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar këto projekte kapitale:

- Pajisje për laborator të Gjeologjisë;
- Pajisje për matjen e vibrimeve dhe zhurmës – Fakulteti i Gjeoshkencave;
- Furnizim me makinë tornuese horizontale (revolver) CNC – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
- Furnizim me material për printer 3D – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
- Material harxhues për laboratorin e Makinerisë – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
- Furnizim me pajisje laboratorike – Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (donacion);
- Pajisje të ndryshme;
- Furnizim me kompjuter;
- Plotësimi i ndriçimit të shtigjeve në parkun e UMIB-it;
- Rregullimi dhe gjelbërimi rreth emblemës;
- Furnizim me pajisje të teknologjisë informative;

Ndër të tjera gjatë vitit 2018 është realizuar edhe një proces me rëndësi i prokurimit me kontratë kornizë: Sistemi i menaxhimit universitar (SMU), që nënkupton sistemin elektronik të menaxhimit të studentëve të UMIB – it dhe modulet tjera sipas kontratës kornizë.

4.9.AUDITIMI

Gjatë viti 2018 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka realizuar auditimin në UMIB. Me këtë rast është bërë “Vlerësimi i aktivitetit ekonomik dhe financiar në Universitetin e Mitrovicës” për vitin 2017. Objekti i kontrollit ishin planifikimi, menaxhimi, shpenzimet, burimi i të hyrave dhe kontrolli financiar i aktiviteteve të realizuar në të gjitha kategoritë ekonomike. Kontrollat financiare të dokumentacionit ishin të përzgjedhura nga auditori i përgjithshëm duke u bazuar në të dhënat, të pasqyruara nga Sistemi i Integruar i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Zyra e Kombëtare e Auditimit për auditimin e kryer nuk ka dhënë vërejtje lidhur me aktivitetet që ishin bazë e auditimit.

4.9.1. Dokumentacioni i kërkuar dhe prezantuar për auditorin e përgjithshëm, të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit të përgjithshëm:

- Implementimi i planit të veprimit të hartuar nga UMIB, lidhur me rekomandimet për vitin 2016, - **rekomandimet ishin të realizuara dhe auditori nuk kishte komente lidhur me çështjet e ngritura;**
- Dokumentacioni lidhur me hartimin e Planit Strategjik të Universitetit, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me dokumentacionin e prezantuar;**

- Dokumentacioni lidhur me aktivitetet për pyetësorët për vetëvlerësim dhe lista e rreziqeve për vitin 2017, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me dokumentacionin e prezantuar;**
- Analiza, menaxhimi dhe kontinuiteti i realizimit të aktiviteteve të planifikuara të bazuar në planin e rrjedhës së parasë, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me dokumentacionin e prezantuar;**
- Buxheti,raportet financiare,kontrollet dhe përputhshmëria me Sistemin e Integruar të Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me dokumentacionin e prezantuar;**
- Analiza, të gjeturat dhe rekomandimet lidhur me aktivitetet e realizuara në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, shërbime dhe mallra dhe shpenzime komunale, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe rekomandime për aktivitetet e zhvilluara në kategorinë paga dhe mëditje duke e cilësuar si proces të mirëfilltë në respektimin e rregullores për të ardhura personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i UMIB-it, gjithashtu edhe për kategorinë ekonomike shërbime dhe mallra dhe shpenzime komunale auditori nuk kishte vërejtje dhe komente lidhur me dokumentacionin e prezantuar;**
- Planifikimi dhe realizimi i planit të prokurimit me theks të veçantë proceset e prokurimit për të gjitha kategoritë ekonomike, - **auditori nuk kishte vërejtje dhe rekomandime për dokumentet e prezantuara duke e cilësuar tërë procesin e realizimit konform dispozitave ligjore.**

V. SIGURIMI I CILËSISË

Për të avancuar procesin e sigurimit të cilësisë dhe për të ndjekur përvojën e universiteteve ndërkombëtare, Universiteti i Mitrovicës ka zbatuar një varg mekanizmesh mbështetës. Me funksionalizimi e mëtejme të Zyrës për Zhvillim Akademik, sigurimi i cilësisë ka zënë vend me rëndësi. Aktualisht zyra përbëhet nga koordinatori qendror për zhvillim akademik (KQZHA) dhe zyrtari i lartë për sigurim të cilësisë. Themelimi dhe funksionalizimi i Komisionit Qendror për Sigurimin e Cilësisë si nën komision i Senatit me përfaqësues të stafit akademik, studentë dhe staf administrativ, është një mekanizëm shtesë në sigurimin e cilësisë.

Objektivat kryesore të zyrës, kanë qenë që të hulumtojë dhe të marrë përvojë nga fusha e sigurimit të cilësisë, pra për mënyrën e funksionimit të këtyre zyrave në universitetet tjera me përvojë të gjatë si në vend dhe jashtë vendit. Në këtë drejtim koordinatori dhe zyrtari i lartë për sigurim të cilësisë u janë përgjigjur të gjitha ftesave për pjesëmarrje në të gjitha organizimet, qoftë në formë punëtorish, takimesh apo seminaresh që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë në arsimin universitar.

Në proces të vetëvlerësimit, zyra përkatëse me kohë ka bërë përgatitjet, ka hartuar pyetësorët, ka shpërndarë dhe ka bërë analizën e përgjigjeve të studentëve. Në pyetësorë janë përfshirë të gjitha lëndët, të gjitha programet, të gjitha vitet, në të gjitha nivelet e studimit, duke përfshirë një numër të

madh pyetjesh që kanë të bëjnë me: angazhimin, bashkëpunimin, vijueshmërinë, qasjen pedagogjike të mësimdhënësve sa i takon mësimdhënies por edhe vlerësimin, pastaj efikasitetin dhe qasjen e personelit administrativ dhe teknik, përfshirë edhe infrastrukturën.

Është me rëndësi të përmenden disa aktivitete të zhvilluara nga zyra për zhvillim akademik:

- Bashkëpunimi permanent i zyrës me Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në proces të akreditimit të programeve të studimeve dhe akreditimit institucional;
- Përgatitja e materialeve të nevojshme për fillimin e projektit “Innovative Teaching Education in Mathematics”, nga programi i Bashkimit Evropian “Erasmus+ Capacity Building in the field of Higher Education”, ku UMIB është partner në këtë projekt, vlera e të cilit është 1 milion Euro. Ky projekt do ketë impakt jo vetëm se si do të ligjërohet matematika në UMIB, por gjithashtu se si lëndët tjera do të dizajnohen dhe prezantohen tek studentët. Në konzorcium janë universitete partnere nga Greqia, Danimarka, Suedia, Austria, Izraeli , Republika Çeke, Uzbekistani dhe Maqedonia.
- Gjatë muajit tetor është regjistruar stafi i UMIB në e- Akreditim, ku ky lloj deklarimi i stafit praktikohet për herë të parë.
- Gjithashtu kemi aplikuar për Riakreditimin Institucional dhe Riakreditim të 7 programeve dhe Akreditimin e 4 programeve të reja sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Programi	Niveli	ECTS	A/R
1.	Inxhinieri dhe Teknologji e Ushqimit	BSc	180	Riakreditimi
2.	Inxhinieri dhe Teknologji e Ushqimit	MSc	120	Riakreditimi
3.	Teknologji	BSc	180	Riakreditimi
4.	Teknologji	MSc	120	Riakreditimi
5.	Vendburimet e lëndëve të para minerale	MSc	120	Riakreditimi
6.	Xehetari	BSc	180	Riakreditimi
7.	Xehetari	MSc	120	Riakreditimi
8.	Inxhinieri Ekonomike	Msc	120	Akreditim
9.	Biznes dhe Menaxhment	Bsc	180	Akreditim
10.	Biznes dhe Menaxhment	Msc	120	Akreditim
11.	Gjeoinformatikë	Bsc	180	Akreditim

VI. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

6.1. Bashkëpunimi me institucione të Republikës së Kosovës, kompani publike dhe private dhe shoqata-organizata tjera

Përveç me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të së cilës Ministri funksionon UMIB-i si program, me qëllim të realizimit të misionit të vet, UMIB gjatë viti 2018 ka pasur bashkëpunim të mirë edhe me Institucionet e Republikës së Kosovës si: Ministrinë e Administratës Publike (MAP)-në kuadër të kësaj Ministrie është duke u menaxhuar projekti për ndërtimin e Kapmusit Universitar të Mitrovicës objekt i dedikuar për nevoja të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM) respektivisht Agjencinë e Veterinarisë dhe të Ushqimit të Kosovës (AVUK), Avokatin e Popullit, Gjykatën Kushtetuese, Komuna e Mitrovicës, etj.

Gjatë vitit 2018, UMIB-i ka pasur disa bashkëpunime me institucione e kompani vendore, si: Oda Ekonomike e Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës, Instituti Shqiptar i Sociologjisë, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe New Co Feronikeli. Këto bashkëpunime janë bërë në dobi të zhvillimit të mësimin, kërkimit shkencor, dhënien e ndihmës për studentët në realizimin e praktikës profesionale dhe mundësinë e shfrytëzimit të literaturës për nevoja shkencore gjatë fazave të hulumtimeve të ndryshme shkencore, projekteve të përbashkëta dhe ndikimit në shoqëri.

Në kuadër të bashkëpunimit me shumë institucione, organizata dhe biznese vendore është mundësuar kryerja e punës praktike profesionale për studentët e UMIB – it.

6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe me IAL publike e private të Kosovës

UMIB ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi si dhe ka vazhduar marrëveshjet e lidhura me të gjitha universitetet publike të Kosovës. Vlen të theksohet se gjatë viti 2018 ka vazhduar punën Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Publike ku shqyrtohen çështje të caktuara në kuadër të përgjegjësisë të parapara me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it dhe me Rregulloren e punës të Konferencës së Rektorëve.

Viti 2018 është shënuar me vazhdim të bashkëpunimit të UMIB-it me disa universitete të shteteve të ndryshme. Përveç takimeve në UMIB ose në ndonjërin nga ato universitete, për këtë qëllim janë përdorur edhe takimet në ngjarjet e ndryshme, në të cilat UMIB ka qenë i ftuar ose pjesëmarrës.

Marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura gjatë vitit 2018:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UMIB dhe Ayt Career & AlbaBerisha Consulting, Turkey, Kosovo;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UMIB dhe Zurich University of Teacher Education , International Projects in Education (IPE), Switzerland;

Gjatë vitit 2018 UMIB ka marrë pjesë në disa konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare të mbajtura në shtete të ndryshme siç janë vizita në: Turqi – Punëtorja e organizuar nga Istanbul AREL University, rreth përgatitjes së KA 107, ERASMUS+ etj.

VII. AKTIVITETET E ZHVILLUARA NË KUADËR TË NJËSIVE AKADEMIKE

Është me rëndësi të përmenden disa aktivitete të zhvilluara në njësitë akademike të UMIB-it: konferenca shkencore, aplikime dhe pjesëmarrje në projekte, seminare dhe ligjërata për studentët dhe personelin akademik si dhe vizita të studentëve dhe personelit akademik në kuadër të konferencave apo vizita të karakterit studimor dhe garues:

7.1.1. Fakulteti i Gjeoshkencave

Gjatë vitit 2018 Fakulteti i Gjeoshkencave ka realizuar edhe bashkëpunime me Fakultete dhe institucione shkencore nga lëmi i gjeoshkencave. Më poshtë po japim disa nga këto bashkëpunime në formë të takimeve e vizitave të dyanshme:

- Universiteti AGH Krakow ka aplikuar në Bashkimin Evropian për Projektin EIT “KAVA Raw Materials” i mbështetur nga EU në kuadër të cilit ka përfshi edhe Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” – Fakultetin e Gjeoshkencave krahas partnerëve tjerë si: Montan University – Leoben, Austria; Geological Survey of Finland; Geological Survey of Slovenia; Geological Survey of Federation of Bosnia&Herzegovina; Geological Survey of Republic of Kosovo. Projekti vazhdon në 3 vitet në vijim. Gjatë vitit 2018 janë bërë kontaktet për realizimin e një kursi 6 ditor me studentët e Departamentit të Gjeologjisë (4 ditë kursi në klasë në formë ligjëratave dhe 2 ditë studim fushor), trajnimi njëjavor i dy studentëve në laboratorët në Finlandë që do të realizohet gjatë vitit 2019.
- Më datë 22.02.2018 për vizitë në Fakultetin e Gjeoshkencave ishin përfaqësuesit e Qendrës për Kërkime dhe Mbikëqyrje të Minierave Nëntokësore (QKMMN) nga Polonia. Në kuadër të këtij aktiviteti për mësimdhënësit dhe studentët e Gjeoshkencave u mbajtë edhe një ligjëratë me titull **"Mbikqyrja profesionale në sistemin e sigurisë së minierave në Poloni"** nga **Dr. Joanna Pruchnicka**. Mësimdhënësit dhe student treguan interesim mjaft të lart si me pjesëmarrje ashtu edhe me diskutime, pyetje e komente.
- Si rezultat i bashkëpunimit me Qendrën për Kërkime dhe Mbikëqyrje të Minierave Nëntokësore (QKMMN) nga Polonia, me datat 11.06.2018 – 17.06.2018, dekani i FGJ prof. dr. Naser Peci dhe senatori prof. dr. Gani Maliqi kanë realizuar vizitë zyrtare në Qendrën për Kërkime dhe Mbikëqyrje të Minierave Nëntokësore (QKMMN) në Poloni si dhe kanë marr pjesë në Konferencën ndërkombëtare Mekanizimi, Automatizimi dhe Robotizmi në Miniera.

- Si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së mirëkuptimit me Kompaninë NewCoFeronikeli – Drenas disa të diplomuar nga Departamenti Materiale dhe Metalurgji dhe Departamenti Xehetarisë janë pranuar në Praktikë profesionale me pagesë si dhe mundësi vazhdimi të punësimit.

7.1.2. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

- Gjatë vitit 2018, respektivisht me 12 dhe 13 shkurt, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore është mbajtur punëtorja “Ecodairy”. Pjesë e organizimit dhe pjesëmarrës kanë qenë FTU dhe Shoqata e Industrisë së Qumështoreve të Kosovës.
- Në kuadër të projektit për shkëmbim të stafit akademik dhe studentëve “Erasmus Mundus, Smart and Green Technologies for Innovative and Sustainable Societies in Western Balkans”, në FTU ka qëndruar Prof. Andriana Surleva nga Universiteti i Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë i Sofjes, përkatësisht Fakulteti i Teknologjisë. Gjatë një muaji sa ka qëndruar në FTU, ajo ka mbajtur ligjërata për studentë nga Kimia Analitike dhe Metodat Instrumentale të Analizës. Njëherazi është shfrytëzuar eksperiencia e saj për përgatitje dhe aplikim të projekteve ndërkombëtare hulumtuese dhe shqyrtimi i mundësisë për inkuadrim të stafit të FTU – së në projekte të BE – së.
- Për një semestër (pranveror), dy studentë të FTU – së i kanë vazhduar studimet në University for Applied Sciences van Hall Larenstein në Holandë me programin Erasmus+.
- Dy studente nga University for Applied Sciences van Hall Larenstein i Holandës e kanë punuar pjesën praktike (eksperimentale) të punimit të diplomës në laboratorët e FTU – së.
- Katër studentë nga University for Applied Sciences van Hall Larenstein i Holandës dhe katër nga FTU – ja, të ndarë në grupe (nga katër) kanë hulumtuar Trajtimin e ujërave shkarkuese nga industrinë e qumështit përkatësisht hulumtimin e hirrës.
- Tre ish studentë të FTU – së i kanë përfunduar studimet e masterit dhe kanë diplomuar në Universitetin e Sofjes në Bullgari, në Departamentin e Bioteknologjisë, nëpërmjet programit Erasmus mundus (green tech).
- Në muajin dhjetor 2018, është mbajtur seminar për trajtimin e ujërave shkarkuese nga qumështoret me pjesëmarrës ekspert holandez dhe studentët e programit Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore.

7.1.3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

- Në kuadër të mobilitetit akademik dhe si rezultat i bashkëpunimit mes UMIB – it dhe Universiteteve tjera, në vitin 2018, me sukses i ka përfunduar studimet e doktoratës në Universitetin e Nidge asistenti Fitim Zeqiri.
- Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi ka marrë pjesë dhe ka prezantuar në dy konferenca ndërkombëtare, në Selanik dhe në Shkup.
- Prof. Ass. Dr. Muzafer Shala, ka ligjëruar në universitetin më të madh publik në Vilnius të Lituanisë.
- Në vitin 2018, në ambientet e FIMK-ut është bërë promovimi i librit "Energjia" i autorit Abdullah Begolli.
- Janë përgatitur dhe përkrahur edhe dy tekste librash të autorëve Prof. Dr. Avni Terziqi e Prof. Ass. Fisnik Osmani, me titull " Mekanika e Fluideve – përmbledhje detyrash me baza teorike" dhe Prof. Dr. Hakif Zeqiri e Prof. Dr. Hysni Osmani, me titull "Materialet e Makinerisë dhe Teknologjia e Materialeve".

7.1.4. Fakulteti Juridik

- Nga janari deri në qershor, në kuadër të Klinikës Juridike Penale, në kuadër të Fakultetit Juridik, çdo javë janë mbajtur ligjërata dhe diskutime me gjyqtar, prokuror dhe avokat. Klinika Juridike Penale është projekt që realizohet falë marrëveshjes së mirëkuptimit të nënshkruar në tetor të vitit 2017, ndërmjet UMIB , përkatësisht Fakultetit Juridik, National Center for State Courts (NCSC) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës.
- Në muajin mars është organizuar debati ndërmjet studentëve të Fakultetit Juridik të UMIB dhe studentëve të Rochester Institute of Technology, të cilët kanë vizituar Fakultetin Juridik të UMIB. Me këtë rast është zhvilluar debat i përbashkët duke shkëmbyer ide dhe perspektiva mbi problemet e ndryshme të shoqërisë kosovare. Gjithashtu në muajin mars grup i studentëve të Fakultetit Juridik kanë marr pjesë në tryezën për Kodin Civil me titull “Barazia Gjinore në Kodin Civil, organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe projekti i Bashkimit Evropian.
- Në muajin maj, studentët e Fakultetit Juridik kanë zhvilluar dy vizita me karakter studimor, njëjën në zyrat e Avokatit të Populli dhe tjetrën në Gjykatës Kushtetuese.
- Në muajin qershor në garën për gjykim të simuluar, të organizuar nga National Center for State Courts (NCSC), studentët e Fakultetit Juridik të UMIB kanë zënë vendin e parë. Ky rezultat ishte arritur falë angazhimit dhe përkushtimit shumë të madh që studentët kishin treguar gjatë gjithë semestrit veror në kuadër të projektit “Klinika Juridike Penale”.

Gjatë muajit dhjetor, gjithashtu në kuadër të Fakultetit Juridik janë zhvilluar shumë aktivitete, përmendim disa sish:

- Në kuadër të aktivitetit “Java kundër korrupsionit”, është mbajtur ligjëratë me studentët lidhur me misionin dhe fushëveprimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, mekanizimin e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit – konfliktit të interesit në Kosovë. Gjithashtu gjatë këtij muaji është mbajtur edhe tryeza e rrumbullakët me titull “Hartëzimi i Nevojave të Komunitetit për Drejtësi”, në të cilën është paraqitur raporti me një analizë të gjerë juridike për mënyrën e funksionimit të ndihmës juridike falas në Kosovë. Gjatë këtij muaji ligjëratë ka mbajtur edhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjeneral Rrahman Rama.
- Me rastin e 10 dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut është zhvilluar debat me temën “Liritë dhe të drejtat e njeriut – sfidat dhe perspektiva”, në debat kanë marr pjesë studentët dhe disa anëtarë të stafit akademik të fakultetit.

7.1.5. Fakulteti Ekonomik

Një ndër objektivat e Fakultetit Ekonomik gjatë viti 2018 ishte implementimi praktik i shumë aktiviteteve jashtë – kurrikulare, të cilat kishin për synim të zhvillojnë shkathtësi praktike të caktuara të cilat nuk ofroheshin nga programi zyrtar i fakultetit. Konkretisht fakulteti ka pasur bashkëpunim të ngushtë me bizneset vendore, ku një numër i madh i studentëve kanë kryer punë praktike në institucione dhe biznese: banka komerciale, kompani sigurimesh, institucione publike, OJQ, trusti pensional, asociacione biznesesh, biznese private etj.

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluar gjatë vitit 2018 vlen të veçohet Tryeza e rrumbullakët e me titull “Institucionet e arsimit të lartë konform kërkesave të tregut rajonal dhe atij ndërkombëtar të punës” Konferenca kishte karakter nacional, morën pjesë Ministria për Inovacione dhe Ndërmarrësi, përfaqësues të gjitha universiteteve publike të Kosovës dhe të fakulteteve të UMIB – it, ekspertë të fushës nga vendi si dhe studentë në pjesëmarrje masive etj.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë për Inovacione dhe Ndërmarrësi, është duke u punuar intensivisht në themelimin e Qendrës për Inovacione dhe Ndërmarrësi.

Në nëntor – dhjetor 2018 është realizuar vizita në Turqi – Punëtorja e organizuar nga Istanbul AREL University, rreth përgatitjes së KA 107, ERASMUS+, lidhur me aplikim në projekte regjionale me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare për thithjen e fondeve akademike.

7.1.6. Fakulteti i Edukimit

Gjatë vitit 2018 Fakulteti, organizoi dy konferenca si dhe morri pjesë në projekte të HERAS:

- Konferenca Rajonale “Familja dhe Edukimi”, ku morën pjesë përfaqësues të MASHT, DKA-ve, kërkues nga rajoni dhe kërkues vendorë, përfaqësues të institucioneve shëndetësore si dhe studentë. Konferenca synon të jetë vjetore.
- Konferenca e dytë që u zhvillua në nëntor 2018, ishte Konferencë Ndërdisciplinore Ndërkombëtare "Vazhdimësia historike dhe ndryshimi: Ballkani në kontekstin evropian dhe global", e cila u zhvillua në bashkë organizim me Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të MASHT, DKA-ve, kërkues nga rajoni dhe kërkues vendorë, përfaqësues të universiteteve dhe studentë. Në konferencën e radhës, UMIB do të jetë bashkorganizator.
- Fakulteti i Edukimit, ka përfituar një projekt të HERAS për ngritjen e bordeve profesionale si mbështetje për Fakultetin e Edukimit.
- Në kuadër të projektit HERAS, Prof. Ass. Eliza Avdiu, ka qëndruar për 1 muaj në Austri si pjesë e studimeve pos-doktorale, ndërsa prof. Besim Gollopeni ka qëndruar, gjithashtu në Austri 2 muaj.
- Në kuadër të aplikimit në projektet e Erasmus+, Fakulteti i Edukimit ka aplikuar si partner edhe në 3 projekte.

Po ashtu, si aktivitete në Fakultetin e Edukimit mund të veçohen:

- Studentët morën pjesë aktive në organizimin e Save the Children për ditën e 1 Qershorit.
- Në bashkëpunim me Institucionin parashkollor “Gëzimi Ynë” në Mitrovicë, studentët tanë lehtësuan organizimin e aktiviteteve për fëmijët dhe prindërit në këtë institucion.
- Gjatë periudhave të ndryshme të vitit, studentët e vitit të dytë, tretë dhe katërt të studimeve, kanë zhvilluar praktikën profesionale në shkollat fillore dhe institucionet parashkollore të komunës së Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrrisë, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe në zhvillimin e tyre të mëtejshëm profesional.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar disa ligjërata me mysafirë nga fusha e edukimit apo fusha të tjera me interes për studentët tanë, të cilat do të jenë në funksion të programeve të studimit.

- Ligjëratë nga znj. Fatime Demolli – Tema e ofruar ishte Vlerësimi i performancës së edukatoreve sipas standardeve – MASHT.
- Ligjëratë nga znj. Mevlude Myrtezi – Tema e ofruar ishte “Metodologjia Majeutike”.
- Ligjëratë nga znj. Hana Saliu – Tema e ofruar ishte “Metodologjia Hap pas Hapi”. Takime të tilla janë mirëpritur nga studentët dhe kanë ofruar mundësi shumë të mira për bashkëbisedim profesional dhe nxitje të mendimit ndryshe.